



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS)

Manuali për kalim nga indeksi në ID(SEMS)

- 1. Qasja në aplikacion*
- 2. Regjistrimi i provimeve të kryera nga indeksi në ID*

1. QASJA NË APLIKACION

Për të hapur SEMS-in duhet te qasemi ne linkun notimi.uni-pr.edu pastaj në Ueb aplikacion na paraqitet dritarja hyrëse e aplikacionit e cila ka formën si në figurën e mëposhtme:

The image shows two parts: a login form on the left and a student ID card on the right. The login form has a header with a warning icon and the text 'Qasja'. Below it is the SEMS logo and the text 'SEMS'. There are two input fields: 'Përdoruesi' and 'Fjalëkalimi'. At the bottom are two buttons: 'Identifikohu' and 'Anulo'. The ID card on the right has the University of Prishtina logo and text: 'UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"', 'UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"', 'Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit', 'Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit'. It also lists: 'Emri / Name:', 'Mbiemri / Surname:', 'Datëlindja / Date of birth:', 'Nr. ID / ID No.:', 'Niveli / Level: Bachelor', 'Statusi / Status: I rregullit', and a barcode. The academic year '2014/2015' is printed below the ID card.

Fig. 1. Qasja në aplikacion.

Sheno fjalëkalimin tuaj (herën e parë sheno numrin tuaj personal, ku pasi te caseni e keni mundesine e ndryshimit te fjalëkalimit)

Në fushën **PËRDORUESI** duhet të shënohet **numri i ID kartelës së studentit** përkatës. Ndërsa tek fusha **FJALËKALIMI** shënohet fjalëkalimi i studentit i cili për herë të parë është: **Numri personal i leternjoftimit të studentit**. Pasi të qaseni ju duhet ta ndryshoni fjalëkalimin tuaj si në figurën me poshte dhe te klikoni butonin **Dërgo** Fig.2

The image shows a form titled 'Ndërrimi i fjalëkalimit'. It has three input fields: 'Përdoruesi', 'Fjalëkalimi', and 'Rishkruaj fjalëkalimin'. There is a 'Dërgo' button at the bottom left.

Fig. 2. Ndryshimi i fjalëkalimit.

2. Regjistrimi i provimeve të kryera nga indeksi në ID(SEMS)

Regjistrimin e kërkesave për tranferim të notave nga indeksi në ID(SEMS) mund ta bëni duke klikuar në menyën **Kërkesat për transferim të notave** e cila ndodhen në anën e majtë të dritares kryesore të SEMS-it, pastaj do të iu shfaqet dritarja **Transferi i notave** si në fig. 3.

The screenshot displays the SEMS web application interface. On the left is a dark sidebar menu with the following sections:

- Lendet**: Zgjedh lëndët obligative, Zgjedh lëndët zgjedhore.
- Fleteparaqitja**: Paraqit provimet, Lista e rezultateve.
- Pagesat**: Pagesat.
- Tjera...**: Transkripti e notave, Kërkesat për transferim të notave.
- Kompetencat**: Kompetencat.
- Universiteti i Prishtinës**: Manuali, SEMS v.2.5.22 2015.

The main content area is titled "Transferi i notave" and contains the following elements:

- Form fields: Fakulteti (FEFS), Departamenti (Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit), Niveli i studimeve (Bachelor), and Lënda (Zgjedhe...).
- Buttons: Kërko, Regjistro kërkesën, and Raporti per transfer.
- Table with columns: Regjistru, Studenti, Profesori, Lenda, Nota, ECTS, and Statusi i kërkesës.
- Callout boxes: "1. Kliko Kërkesat për transferim të notave" and "2. Kliko Regjistro kërkesën".

Fig. 3. Kërkesat për transferim të notave

-Pastaj klikojmë në butonin **Regjistro kërkesën** dhe na shfaqet dritarja **Informim** si në figurën e poshtëshenuar, tek e cila duhet t'i plotësojmë të gjitha fushat

The image shows a web form titled "Informim" with the following fields and callouts:

- 1. Zgjedh nivelin e studimeve**: Points to the "Niveli Studimeve" dropdown menu.
- 2. Zgjedhe lenden/provimin që e keni përfunduar**: Points to the "Lenda" dropdown menu.
- 3. Zgjedh Statusin e lëndës**: Points to the "Statusi i lëndës" dropdown menu.
- 4. Sheno: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit - Prishtinë**: Points to the "Fak./Dep./Vendi/Shteti ku janë kryer provimet" text input field.
- 5. Sheno numrin e dosjes tuaj**: Points to the "Nr. dosjes ku keni kryer provimet" text input field.
- 6. Sheno emrin dhe mbiemrin e profesorit për lëndën përkatëse**: Points to the "Profesori" text input field.
- 7. Sheno numrin e kredive për lenden përkatëse**: Points to the "ECTS" text input field.
- 8. Zgjedh notën të cilën e keni në lenden përkatëse**: Points to the "Nota me shkrim" dropdown menu.
- 9. Sheno datën kur e keni kryer provimin në lenden përkatëse**: Points to the "Data e provimit" date picker.
- 10. Pasi t'i keni plotësuar të gjitha fushat, kliko butonin Përfundo**: Points to the "Përfundo" button.

Other visible fields include "Fakulteti" (FEFS), "Departamenti" (Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit), "Nota me gojë", and "Nota përfundimtare".

Fig. 4. Plotësimi i fushave në dritaren Informim

Në figurën 4 duhet të plotësohen të gjitha fushat për lëndën/provimin përkatës duke u bazuar në provimet që keni kaluar dhe që i keni të shënuar në indeks. Tek fusha **“Data e provimit”** duhet të shënoni datën se kur e keni kaluar provimin në lëndën e caktuar. Te fusha **ECTS** duhet të shënoni numrin e kredive të lendeve duke u bazuar në planprogramin që keni degjuar lëndet kur jeni regjistruar në Fakultet.

Krejt në fund pasi t’i keni plotësuar të gjitha fushat klikoni butonin **përfundo**.

Kjo procedurë duhet të ndjeket për të gjitha provimet që i keni të përfunduara dhe që iu figurojnë në indeks, pra të bëhet kërkesë për transfer të notave për secilin provim të kryer veq e veq.

Pasi t’i keni kryer të gjitha kërkesat për transferim të notave nga indeksi në ID në fund ju duhet ta printoni **“Raporti për transfer”** dhe bashkë me Indeks t’a dorëzoni të referentët. Si në figurën 5.

The screenshot displays the SEMS web application interface. On the left is a dark sidebar menu with various navigation options. The main content area is titled 'Transferi i notave' and contains several dropdown menus for filtering: 'Fakulteti' (FEFS), 'Departamenti' (Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit), and 'Niveli i studimeve' (Bachelor). Below these are fields for 'Lënda' and an 'Aprovuar' checkbox. A table with columns for 'Kërko', 'Regjistro kërkesen', 'Raporti për transfer', 'RegistriID', 'Studenti', 'Profesori', 'Lënda', 'Nota', 'ECTS', and 'Statusi i kërkesës' is visible. A callout box with a black border and white background points to the 'Raporti për transfer' button, containing the text 'Në fund printo Raportin për transfer'.

Fig. 5. Shtypja e raportit përfundimtar

Vërejtje: Të gjitha kërkesat që studentët i bëjnë për transferim të notave nga **indeksi në ID** do të verifikohen nga referentët.